


“TEKSTET SHKOLLORE”

PERCEPTIMI I NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA NË LIDHJE ME



Këshilli i Nxënësve të Kosovës
Student Council of Kosovo

**SCHÜLER
HELPEN
LEBEN**

Raporti i hulumtimit

"Perceptimi i Nxënësve të shkollave të mesme të larta në lidhje me Tekstet Shkollore"

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Building a Generation of Impact through Student Council" me mbështetje të Schuler Helfen Leben (SHL) dhe implementuar nga Këshilli Rinor Kosovar (KYC). Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin medoemos qëndrimet e autorëve/rishikuesve, KYC-it apo të donatorëve.

KYC

Prishtinë 10000, Kosovë

kyckosova@gmail.com

+383 (44) 96 45 75

Të drejtat e autorit © 2023. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

Fq. 6

H Y R J E

Faqe 8

M E T O D O L O G J I A

Faqe 9

**A N A L I Z A E
S I T U A T Ë S**

Faqe 10

**A N A L I Z A E
T Ë D H Ë N A V E**

HYRJE

Këshilli Rinor Kosovar (KYC) është një nga organizatat më të vjetra jo-qeveritare rimore e themeluar në vitin 1999 në kampet e refugjatëve në Shqipëri, dhe e regjistruar zyrtarisht më vonë gjatë atij viti në Prishtinë, Kosovë. KYC aspiron të punojë drejt ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë përmes promovimit të iniciativës, mbështetjes së të rinxve, angazhimit të vajzave dhe djemve në proceset vendimmarrëse, fuqizimit të kapaciteteve të tyre, përfaqësimit të zërit rimore, promovimit të edukimit të vetë-organizuar dhe mbështetjen e zhvillimit të politikave rimore.

Rinia është në qendër të organizatës dhe e gjithë puna zhvillohet në bazë të këtyre kanaleve: stafit, vullnetarëve dhe strukturave përfaqësuese. Të rinjtë, pra, janë motori i organizatës me të cilët ne synojmë të rrisim cilësinë në arsim.

KYC bashkëpunon me institucionet arsimore, organizata jo-fitimprurëse, institucionet publike dhe institucionet tjetra, për të ruajtur një shkallë të lartë të mirëqenies, edukimit dhe aktivizimit të rinxve në komunitetet e tyre. Ndërsa bashkëpunimet e shumëta, KYC është në partneritet me Fondacionin Gjerman - Schüler Helfen Leben (SHL) në projektin “Fuqizimi i Këshillit të Nxënësve të Kosovës (KNK)”.

Këshilli i Nxënësve të Kosovës është struktura më e madhe nationale e përfaqësimit të zërit të nxënësve, me një përfshirje prej 106 shkollave të mesme të larta në 29 komuna të vendit, të cilat në bazë të Statutit të KNK-së, cdo vit zgjedhin Këshillin Drejtues të KNK-së (të përbërë nga përfaqësues nga secila komunë), organ i cili mblidhet rregullisht dhe koordinon aktivitetet e KNK-së.

KNK ka për qëllim përfaqësimin e mendimeve dhe nevojave të nxënësve, në tryeza institucionale, ngjarje avokuese dhe në takime vendim-marrëse, në nivel shkolle, nivel komunal apo nacional. Të organizojnë aktivitete të ndryshme në të mirë të nxënësve dhe të ndihmojnë në zhvillimin e cilësisë në arsim. Në mesin e aktiviteteve të shumëta për zhvillimin e cilësisë në arsim, është edhe aktiviteti i realizimit të hulumtimeve për të kuptuar më mirë situatën aktuale të edukimit para-universitar në Kosovë.

KYC në raportimet e mëhershme në lidhje me "Cilësinë në Arsim - Përceptimin e Nxënësve në lidhje me Përbajtjen, Procesin dhe Mjedisin mësimor", në 29 komuna të Kosovës (shumicë shqiptare, 2022), si dhe raportimeve të mëhershme në nivel Kosove (2010, 2016), ka kuptuar më shumë për perceptimin e nxënësve në lidhje me këtë çështje. Nëpërmjet këtyre raporteve, KYC ka ofruar rekomandime drejt politikave, iniciativave dhe aktiviteteve që duhet ndërmarrë për avancimin në edukim.

Së fundmi, duke parë nevojën për hulumtim drejt teksteve shkollore, është vlerësuar si i duhur realizimi i hulumtimit në lidhje me "Përceptimin e Nxënësve mbi Tekstet Shkollore".

METODOLOGJIA

Ky hulutim është realizuar për të kuptuar përceptimin e nxënësve të shkollave të mesme të larta të Kosovës rreth literaturës shkollore të tyre, dhe është pjesë e iniciativës “Tekstet Shkollore”. Hulumtimi ka dizajn sasior, me ç'rast është përdorur pyetësori si bazë kryesore për mbledhjen e të dhënave. Ky pyetësor është realizuar nga Grupi i Hulumtimit, në kuadër të Këshillit të Nxënësve të Kosovës (KNK), në bashkëpunim me ekspertë të fushës, dhe është ri-shikuar edhe nga stafi i KYC. Pyetësori është ndarë përmes platformës online “Google Forms”, gjatë periudhës Mars – Qershor, 2023, tek nënësit e shkollave të mesme të larta të Kosovës, për të evidentuar problematikat rreth teksteve shkollore dhe në këtë mënyrë është administruar, krejtësisht në formë anonime.

Pyetësori ka përfshirë disa dimensione, duke filluar prej pyetjeve demografike që janë kërkuar gjinia, mosha, klasa, rajoni ku jetojnë dhe shkolla ku vijojnë mësimet. Pastaj, pyetësori përfshiu dimensionin e literaturës shkollore me pytje rreth qasjes në burime të informacionit, ofrimi i burimeve ose mbështetje shtesë për të kuptuar literaturën sfiduese. Pjesë tjetër me rëndësi ishte edhe gjithëpërfshirja kulturore dhe këndvështrimet e ndryshme kulturore në literaturë shkollore, përditësimi i literaturës me njohuri të reja shkencore, përputhja e librave dhe materialeve që mësojnë me kurrikulën, mundësia për të dhënë komente për cilësinë e literaturës dhe marrja parasysh e këtyre komenteve nga ana e mësimdhënësve. Dimension tjetër i pyetësorit ishte edhe përdorimi i skriptave në vend të librave nëpër lëndë të caktuara, cilat janë ato lëndë, ekzistimi i një komiteti të caktuar përgjegjës për përzgjedhjen dhe monitorimin e literaturës, si dhe pjesa ku nxënësit mund të përgjigjen se sa janë të kënaqur me literaturën shkollore, dhe të jepin rekomandime të ndryshme në lidhje me këtë çështje.

Në përgjithësi janë anketuar 755 nxënës të shkollave të mesme të larta në 7 rajone të Kosovës. Rajoni i Prishtinës përfshiu 52.6%, Ferizaj 13.2%, Gjilan 12%, Gjakovë 9.52%, Prizren 5.2%, Pejë 4.1%, dhe Mitrovica 3.3%. Prej numrit të përgjithshëm të respondentëve, 69.9% janë vajza, 26.6% janë djemë dhe 3.4% prej tyre kanë preferuar mos të përgjigjen. Ndërsa sa i përkët moshës së tyre, 32.6% - 17 vjeçar, 32.5% - 16 vjeçar, 18% - 15 vjeçar, 16% - 18 vjeçar, 0.4% - 19 vjeçar, 0.4% - 20 vjeçar, 0.1% - 14 vjeçar.

Administrimi i pyetësorit përmes formës online mund të cilësohet si limitim, për faktin se administrimi online kufizon kontrollin e hulumtuesve mbi mënyrën se si respondentët kanë kuptuar përshkrimin e pyetjeve dhe mënyrën e plotësimit, dhe gjithashtu mund të ngritë shqetësimin rreth besueshmërisë së përgjigjeve.

ANALIZA E SITUATËS

Këshilli i Nxënësve të Kosovës (KNK), ndër vite ka pranuar ankesa të shfaqura nga nxënësit e shkollimit të mesëm të lartë, në lidhje me përdorimin, përbajtjen dhe mungesën e librave e materialeve mësimore.


Gjatë vitit 2022, KYC në bashkëpunim me KNK, ka lansuar raportin "Cilësia në Arsim", ku njëra nga temat e trajtuarë ka qenë edhe "Literatura Shkolllore". Përmes këtij hulumtimi, nxënësit kanë raportuar se: 69.9% e nxënësve u pajtuan se është shumë e vërtetë apo e vërtetë deri diku deklarata që tekstet e librave mësimore përbajnjë gabime drejtshkrimore; për të njejtën vërtetësi 39.9% u pajtuan që tekstet e librave mësimore përbajnjë gabime faktike; dhe 68.1% që tekstet e librave nuk janë të ri-freskuara me informata të reja; 30% e nxënësve deklaruan se është aspak i vërtetë apo i pavërtetë deri diku konstatimi që ata përdorin libra mësimore për çdo lëndë; për të njejtën vërtetësi 67.7% deklaruan se ata përdorin skripta për të mësuar lëndët; dhe 34.8% se ata përdorin libra të cilat nuk janë pjesë e kurrikulës; Ndërkohë, 63.7% e pjesëmarrësve deklaruan se atyre shpeshherë apo gjithmonë iu diktohet mësimi nga mësimdhënësi gjatë klasës. Andaj, këto rezultate ishin edhe ndër arsyet kryesore për zhvillimin e këtij hulumtimi.

Përveq kësaj, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) po angazhohet në hartimin e një ligji të ri për tekste shkolllore. Një qëllim thelbësor i këtij reporti është se ky dokument nuk do të mbetet vetëm një tentativë për të kuptuar më mirë situatën në terren, por do të përdoret si një dokument i fuqishëm për avokim, përgjatë procesit të hartimit të ligjit të ri. KNK po bën përpjekje të rëndësishme për të siguruar përfshirjen e vazhdueshme të zërit të nxënësve në përmirësimin e teksteve shkolllore. Në këto përpjekje për transparencë dhe përfshirje, KNK ka lancuar platformën e tyre të emëruar, "#RAPORTO," ku nxënësit mund të raportojnë problemet dhe kërkesat e tyre në shkollat e mesme të larta, përfshirë edhe problemet në lidhje me tekstet shkolllore. KNK kërkon që ankesat e drejtpërdrejta të nxënësve, të raportuara përmes kësaj platforme, të pranohen dhe trajtohen nga MASHTI, specifisht nga Sektori për botimin e teksteve shkolllore, në kuadër të Institutit Pedagogjik të Kosovës.

ANALIZA E TË DHËNAVE

5. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të miaj në shkollën e mesme, unë kam pasur qasje në burime të ndryshme informacioni për një lëndë të caktuar.

Në bazë të rezultateve, tek pyetja rreth burimeve të informacionit për lëndë në shkollë, si dhe ofrimi i burimeve apo informacioneve mbështetëse për të kuptuar literaturën sfiduese, raportohet se ekziston një numër i vogël i qasjes në burime të ndryshme informacioni për një lëndë të caktuar. Nga totali i 749 nxënësve, 15.9% raportuan se nuk kanë qasje në burime të ndryshme informacioni në asnjë lëndë të caktuar në shkollë; 43.4% raportuan se kanë qasje në një deri në tri lëndë; 20.7% raportuan se kanë qasje në katër deri shtatë lëndë dhe 20.2% e nxënësve raportuan se kanë qasje në më shumë se shtatë lëndë.



Pyetja 5

6. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të miaj në shkollën e mesme, mua më janë ofruar burime ose mbështetje shtesë për të kuptuar literaturën sfiduese.

Kurse te ofrimi i burimeve ose mbështetjes shtesë për të kuptuar literaturën sfiduese poashtu të dhënat tregojnë një numër të vogël të ofrimit të informatave të tilla tek nxnënësit. Nga totali, 33.6% e tyre raportuan se nuk u ofrohen burime ose mbështetje për të kuptuar literaturën sfiduese; 39.1% raportuan se kanë pasur qasje në një deri tri lëndë; 14.8% raportuan se kanë qasje në katër deri shtatë lëndë; dhe vetëm 12.4% e tyre raportuan se kanë qasje në më shumë se shtatë lëndë.

Shënim: Tek kjo pyetje, pjesëmarrësit kanë pasur mundësi që nëse përgjigja ishte po, në vazhdimësi do mund të tregonin edhe formën sesi janë ofruar materialet ndihmuese për literaturën sfiduese.



Pyetja 6

6.1 Më janë ofruar videot

Në pytjen e ofrimit të videove, nga numri total i 497 përgjigjeve, ishin këto rezultate: 47.7% u përgjigjën me opsonin e në një deri tri lëndë u janë ofruar video për literaturësn sfiduese, 29.36% janë përgjigjur se në asnje lëndë nuk u janë shfaqur ndonjë video, 14.5% e nxënësve raportuan se në katër deri shtatë lëndë u janë shfaqur video, si dhe vetëm 8.2% e tyre raportuan se u shfaqen video ndihmuese në më shumë se shtatë lëndë.

6.2 Më janë ofruar libra


Në pytjen e ofrimit të librave, nga 497 përgjigje, 38.4% e tyre raportuan se në asnje lëndë nuk ka pasur ofrim të tillë, 25.2% e nxënësve raportuan se në një deri tri lëndë u janë ofruar libra shtesë për të kuptuar literaturën, 23.1% i tyre raportuan se në më shumë se shtatë lëndë u janë ofruar libra, si dhe 13.3% prej tyre raportuan se në katër deri shtatë lëndë kanë pasur mundësi të kenë libra shtesë për të kuptuar literaturën sfiduese.

6.3 Më janë ofruar materiale të tjera mësimore (skripta, shkrime etj.)


Në pyetjen e rradhës, poashtu nga 497 përgjigje, e cila ishte për ofrimin e materialeve tjera mësimore (skripta, shkrime etj.), 46.9% e nxënësve raportuan se u ofrohen materiale të tilla në një deri tri lëndë, 18.1% e tyre raportuan se në katër deri në shtatë lëndë kanë mundësi marrin materiale shtesë, si dhe 17.5% në më shumë se shtatë lëndë, dhe po me të njejtat vlera ishin edhe për opsonin e asnjërsës lëndë.



Pyetja 6.1.



Pyetja 6.2.



Pyetja 6.3.


Shënim: Në fund të këtij dimensioni, ishte edhe pyetja e ndonjë forme tjetër që kanë ofruar mësimdhënësit për materiale shtesë.

6.4. Tjetër (Shkruaj nëse të janë ofruar burime të tjera)

Disa prej përgjigjeve ishin: me shëним, diktime, dokumente të ndryshme, projekte, mësim në kurse, hulumtime të vet profesorit nga interneti, dhe fleta punuese.

7. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të mijë në shkollën e mesme, literatura e përdorur ka pasur gjithëpërfshirje kulturash dhe këndvështrimesh.


Tjetër qëllim i këtij hulumtimi ka qenë edhe gjithëpërfshirja e kulturave dhe këndvështrimeve. Në grafikonin e mëposhtëm mund të shihen 16.3% e nxënësve kanë raportuar se në asnjë lëndë nuk ka gjithëpërfshirje të tillë; 34.2% prej tyre kanë raportuar se në një deri në tri lëndë ka gjithëpërfshirje të tillë; 11.9% kanë raportuar se ka gjithëpërfshirje në katër deri në shtatë lëndë; në vetëm 7.7% është raportuar se ka gjithëpërfshirje në më shumë se shtatë lëndë, si dhe 29.9% raportuar se nuk e dijnë se a ekziston një gjithëpërfshirje e tillë kulturash dhe këndvështrimesh.



Pyetja 7

8. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të mia në shkollën e mesme, librat dhe materialet e literaturës kanë qenë të përditësuara me njohuri të reja shkencore.


Çështje tjetër me rëndësi ishte edhe pjesa e mësimeve, ku është tentuar të kuptohet se a kanë qenë të përditësuar librat dhe materialet e literaturës me njohuri të reja shkencore. Në gjithsej prej 749 përgjigjeve, 21.6 % e nxënësve raportuan se në asnjë lëndë nuk ka pasur përditësim të tillë; 32.4% raportuan se ka pasur përditësim në një deri në tri lëndë; 15.5% e nxënësve pohuan se në katër deri shtatë lëndë ka pasur përditësim shkencor; pastaj vetëm 14% raportuan se ka pasur përditësim në më shumë se shtatë lëndë, si dhe 16.4% e nxënësve u përgjigjen me nuk e di.



Pyetja 8

9. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të mia në shkollën e mesme, librat dhe materialet e literaturës kanë qenë në përputhje me kurrikulën.

Një e gjetur tjetër e rëndësishme është edhe përputhshmëria e kurrikulave që ofrohen nga Ministria, me librat dhe materialet e literaturës. Nga rezultatet mund të shihet se 15.5% e nxënësve raportuan se nuk ka përputhje me kurrikulën asnjë lëndë që ata e mësojnë; 21.9% e tyre raportuan se në një deri tri lëndë ka përpuethshmëri; 16.2% raportuan se në katër deri shtatë lëndë ka përpuethshmëri në mes kurrikulës dhe librave e materialeve mësimore; 27.2% prej tyre raportuan se ka pëpueuthshmëri në më shumë se shtatë lëndë, si dhe 19.2% u përgjigjen me nuk e di.




Pyetja 9

10. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të mia në shkollën e mesme, më është dhënë mundësia të jap komente për cilësinë e literaturës që përdoret në klasë.

Kur jemi tek pjesa e literaturës, me interes ishte edhe çështja e komenteve apo edhe sugjerimet e nxënësve kur është puna tek literatura dhe të dhënat që konsiderohen të rëndësishme për cilësinë e literaturës. Pyetja e rradhës që ishte e përfshirë në hulumtim ishte ajo që nxit pikëpamjen e nxënësve në lidhje me mundësinë e dhënieve së komenteve të tyre në lidhje me literaturën që përdoret në klasë. Si dhe nëse janë ankuar ndonjëherë për cilësinë e dobët të literaturës a janë marrë parasysh komentet.


Në rastin e parë rezultatet mund të shihen tutje; 35.9% e nxënësve raportuan se nuk u është dhënë mundësia të komentojnë në lidhje me cilësinë e literaturës që është përdorur në klasë; 30% e tyre raportuan se kjo mundësi i'u është dhënë në një deri në tri lëndë; 12.7% e tyre raportuan se kanë pasur mundësi në katër deri shtatë lëndë; 21.4% raportuan se në më shumë se shtatë lëndë u është dhënë mundësia e tillë.



Pyetja 10


11. Në rast se ka ndodhur të ankohem unë, ose ndonjë shok/shoqe, ndonjëherë për cilësinë e dobët të literaturës, komentet tona janë marrë parasyshë.

Ndërsa, tek pyetja e ankesës në lidhje me marrjen parasysh të komenteve nëse i kanë bërë për literaturën, shohim rezultate të tillë si; 33.5% i tyre raportuan se në asnjë lëndë nuk u janë marrë parasysh komentet apo sugjerimet për cilësinë e dobët të literaturës, 16.4% i nxënësve pohuan se komentet u janë marrë parasyssh në një deri tri lëndë; vetëm 4.9% e tyre raportuan se u janë marrë parasysh komentet në katër deri shtatë lëndë; 8.8% raportuan se në më shumë se shtatë lëndë profesorët e tyre kanë marrë parasysh komentet, si dhe një vlerë e konsiderueshme e tyre nuk janë ankuar, 36.3%.



11.1 Nëse është bërë ankesë: Si është trajtuar çeshtja?

Çeshtja e fundit sa i përket ankesave ishte edhe forma se si ishte trajtuar ankesa/çeshtja e hapur, nga ana e mësimdhënësve. Në këtë pyetje mundësia ishte për përgjigje të hapura, dhe për sqarimin e formës se si është pritur dhe trajtuar çeshtja e ankesave. Nga totali i 477 përgjigjeve, 41.9% e tyre raportuan se çeshtja është anashkaluar si ankesë, 27.5% e nxnësve pohuan se është marrë parasysh si çeshtje dhe është zgjidhur, si dhe 26.6% treguan se është marrë parasysh por nuk është gjetur zgjidhja.



Në kuadër të kësaj pyetje, ka pasur hapësirë edhe për opsione tjera, dhe ndër opsonet e shumëta në përgjigje ishin: "janë pajtuar me mendimin por asgjë më shumë, nuk janë ankuar asnjëherë sepse nuk merret parasysh", "nuk kanë dashur të dëgjojnë mësimdhënësit, nuk lejohet mendimi kundër dhe bëhet presion për mësime vetëm sipas tyre dhe na mohojnë mendimin kundër duke thënë se na ngelin administrativisht", "nuk kanë besuar, ka pasur vështirësi në zgjidhje" etj.

"Ka mbet pezull!"

"Është anashkaluar dhe trajtuar në mënyrën më të keqe të mundshme"

"Jane pajtuar me mendimin por asgje me shume"

"Nuk jemi ankuar asnjehere sepse e dim qe nuk merret parasysh"

"Është anashkaluar si kërkësë"

"nuk kan dashur as qe te degjojn"

"Nuk lejohet mendimi kunder dhe bëhet presion per mesime vetem sipas tyre dhe na mohojne mendimin kunder duke thene se na ngelin administrativisht"

"Nuk kan besu"

"Gjithmone eshte mare parasysh, por ndonjehere eshte bere një zgjidhje ndonjehere jo."

"Nuk dihet per fatin e saj"

"Vetem eshte marr parasysh"




"Ndonjehere ka pasur veshtrësi ne zgjidhje"

"Dhe ne raste kan ofendur se ne kemi then qe nuk po kuptojm"

"Disa profesor kane marrë parasysh mendimin tonë e disa kan vazhduar me metoden e vetit"

12. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të mijë në shkollën e mesme, janë përdorur skripta në vend të librave.


Pjesa e tretë e hulumtimit përfshiu çështjen e përdorimit të skriptave në vend të librave në shkollat e mesme. Nga totali i 749 respondentëve, të dhënat tregojnë një masë të madhe të këtyre rasteve; 27.4% e nxënësve raportuan se në asnjë lëndë nuk kanë përdorur skripta. Kurse në të gjitha rastet e tjera, nxënësit pohuan se kanë përdorur skripta; 43.3% e nxënësve raportuan se në një deri tri lëndë mësojnë me skripta në vend të librave, 15.1% raportuan se në katër deri në shtatë lëndë përdorin skripta në vend të librave, si dhe 14.3% e tyre pohuan se me skripta mësojnë në më shumë se shtatë lëndë.



Pyetja 12


12.1 Nëse janë përdorur skripta; Në cilat lëndë janë përdorur?

Pyetja pasuese ishte në lidhje me cilat lëndë kanë pasur skripta në vend të librit. Pyetja ishte me mundësi në përgjigje përpos lëndëve që u janë shkruar si opsione. Prej përgjigjeve të nxënësve shihet se lënda është raportuar se përdoret më së shumti skripta është lënda e biologjisë me 40.4%, më pas lënda e gjuhës shqipe me 23.2%, fizika me 14.2%, lënda e matematikës me 13.6%, gjuha angleze me 13.1%. Përpos këtyre lëndve ishin të cekura edhe lëndët si psikologjia, edukata fizike, arti figurativ, kimia, filozofia, sociologji, si dhe disa lëndë zgjedhore si: mësimi zgjedhor, të drejtat e njeriut dhe siguria në internet, Akaidi, lënda e Kur'anit, bazat e elektroteknikës, dizajni grafik, etika në shëndetësi, materialet dhe komponentet elektroteknike, gjuhët programuese, anatomia e lëndë të ngjashme ku nxënësit u janë referuar në përgjithësi.




13. Në shkollën time ka komitet të caktuar përgjegjës për përzgjedhjen dhe monitorimin e literaturës së përdorur.

Qëllimi apo dimensioni i fundit i hulumtimit ishte në lidhje me komitetin e caktuar përgjegjës për përzgjedhjen dhe monitorimin e literaturës që përdoret. Kjo pyetje ka pasur 3 opsione në përgjigje, ku nëse përgjigja ka qenë po, minden me vazhdu me u përgjigj edhe në pyetjet e mëposhtme. Nga totali i 749 përgjigjeve, gjithësej 70.8% e nxënësve raportuan se nuk e dinë se a ekziston një komitet i tillë në shkollë, 16% prej tyre raportuan se nuk kanë një komitet të tillë në shkollë, si dhe vetëm 13.2% prej nxënësve raportuan se kanë komitet të caktuar që merret me çështjen e literaturës.



13.1. Nëse PO; Kush e përbën atë?

Pyetja tjetër kishte të bënte me përbërjen e këtij komiteti. Nga gjithësej 99 përgjigje, 34.2% e nxënësve treguan se ky komitet përbëhet nga grupei mësimdhënësve, 25.8% e tyre raportuan se komiteti përbëhet nga grupei nxënësve, 27.5% e tyre raportuan se komiteti përbëhet nga mësimdhënës, 10% e tyre raportuan se komiteti përbëhet nga nxënës, dhe 2.5% raportuan përmes opsonit “tjetër”, ku nga ta 1% raportuan se nuk e dinë.




Pyetja 13.1.

13.2 Nëse JO; A mendoni se duhet të ketë një komitet monitorues përliteraturen shkollorë?


Pyetja tjetër kishte të bënte me ekzistencën e këtij komiteti. Nga gjithësej 650 përgjigje, 89.1% e nxënësve mendojnë se shkolla duhet të ketë një komitet monitorues përliteraturën shkollore, ndërsa 10.9% e tyre mendojnë se nuk duhet të ketë një komitet të tillë.

13.2.1 Nëse PO; Nga kush duhet të përbëhet?

Pyetja tjetër kishte të bënte me përbërjen e këtij komiteti. Nga gjithësej 574 përgjigje, 8.4% e nxënësve treguan se ky komitet duhet të përbëhet vetëm nga mësimdhënësit, 4.4% e tyre raportuan se ky komitet duhet të përbëhet vetëm nga nxënësit, ndërsa 89.4% e tyre raportuan se ky komitet duhet të përbëhet nga të dy palët.




Pyetja 13.2.



Pyetja 13.2.1.

14. Në përgjithësi, sa jeni të kënaqur me literaturën shkollore?

Dhe pjesa e fundit e hulumtimit ka të bëjë me nivelin e kënaqshmërisë ndaj literaturës shkollore në shkollën që ata vijojnë mësimin. Mundësitetë në përgjigje ishin me shkallën e Likertit, prej 1 (aspak i/e kënaqur) deri në 5 (shumë i/e kënaqur). Në gjithësej 749 nxënës, 12.3% e tyre e kanë vlerësuar me 1, 16.7% e tyre e vlerësuan me 2, 34.7% e tyre e vlerësuan me 3, 19.2% e tyre e vlerësuan me 4, si dhe 17.1% e tyre e vlerësuan me 5.



15. A keni ndonjë koment, propozim, ankesë rreth literaturës shkollore për të shtuar?

Në pyetjen e fundit, nxënësit kanë pasur mundësinë që të shtojnë komente, ankesa apo propozime rreth literaturës shkollore. Këto janë disa nga përgjigjet e tyre!

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| "Mos me pas perdorim tifialeve angleze nteksje shqip" | "Me pas me shum bisedime rreth qeshtjes per te gjetur zgjedhje rreth literatures sepse eshte e veshtir te gjenden materialet per lenden e caktur dhe po kem shum shpenzime" | "Shkaku i mungesës te informacioneve neper libra shkollor dhe mos-perputhen e librave me kurrikulen, shpeshhere mesimdhensit kerkojnë nga ne per te kerkuar ne internet informacione shtese dhe te nxerrim shenime." | "Te behet perditsimi i librav shkollor nuk perputhen me statistikat apo te rejat qe kan ndodhur vitet e fundit sidomos ne gjeografi" | "Ndalimi i shperndarjes se skriptave cdo ore ne nje lende te caktuar" |
| "Njohurit e reja shkencore te shfagjen ne libra dhe literaturre te jetë sa më e kuptueshme dhe jo perkthim nga literatura angleze" | "Duhet qe ta marrim nga interneti" | "Te perputhen me kurrikule, te jene te kuptueshme edhe atraktive" | "Te behet perditsimi i librav shkollor nuk perputhen me statistikat apo te rejat qe kan ndodhur vitet e fundit sidomos ne gjeografi" | "Mendoj qe ne lendet prodesionale ne vend te skriptave duhet te kemi libra ndersa ne lendet e përgjithshme duhet te kemi libra te Teknikes jo te Gjimnazit." |
| | "Literatura shkollore shpesh permban gabime te papranuara ne permbajtje dhe shpesh nuk perputhet me korrikulen." | "Literatura e ofruar nuk eshte ne pershtatje me kurrikulen e re. Ne si nxenes por ne te njeften kohe edhe profesoret hasim veshtiresi qdo dite qe ti pershtatemi kurrikules se re. Nuk kemi literature te pershtatshme per zhvillimin e ores mesimore sipas kurrikules se re." | "Mendoj qe ne literatura shkollore duhet vleresuar nga pedagog/psikolog, te cilët e vleresojnë sasine dhe cilesine e mesimeve qe nxenesit mund ta absorbojne me lehte." | |
| | "Ankesa te theksuara per librin e kimise se klases se 11." | | | |

Tabela nr. 1. Pyetësori i përdorur

| 1. Gjinia | 2. Mosha | 3. Klasa | 4. Rajoni |
|--|---|----------------------------|-----------|
| 5. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të myja në shkollën e mesme, unë kam pasur qasje në burime të ndryshme informacioni për një lëndë të caktuar. | Në asnjë lëndë | Në katër deri shtatë lëndë | |
| | Në një lëndë deri tri lëndë | Më shumë se shtatë lëndë | |
| 6. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të myja në shkollën e mesme, mua më janë ofruar burime ose mbështetje shtesë për të kuptuar literaturën sfiduese | Në asnjë lëndë (Nëse zgjedhet kjo përgjigjje; kalohet direkt tek pyetja 7) | Në katër deri shtatë lëndë | |
| | Në një lëndë deri tri lëndë | Më shumë se shtatë lëndë | |
| Nëse PO: Cilat burime ose mbështetje shtesë për të kuptuar literaturën sfiduese, ju janë ofruar? | | | |
| 6.1 Më janë ofruar videot | 6.2 Më janë ofruar libra | | |
| Në asnjë lëndë | Në asnjë lëndë | Në katër deri shtatë lëndë | |
| Në një lëndë deri tri lëndë | | | |
| Në katër deri shtatë lëndë | Në një lëndë deri tri lëndë | Më shumë se shtatë lëndë | |
| Më shumë se shtatë lëndë | | | |
| 6.3 Më janë ofruar materiale të tjera mësimore (skripta, shkrime etj) | 6.4. Tjetër (Shkruaj nëse të janë ofruar burime të tjera) | | |
| Në asnjë lëndë | | | |
| Në një lëndë deri tri lëndë | | | |
| Në katër deri shtatë lëndë | | | |
| Më shumë se shtatë lëndë | | | |
| 7. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të myja në shkollën e mesme, literatura e përdorur ka pasur gjithëpërfshirje kulturash dhe këndvështrimesh. | Në asnjë lëndë | Në katër deri shtatë lëndë | Nuk e di |
| | Në një lëndë deri tri lëndë | Më shumë se shtatë lëndë | |
| 8. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të myja në shkollën e mesme, librat dhe materialet e literaturës kanë qenë të përditësuara me njohuri të reja shkencore. | Në asnjë lëndë | Në katër deri shtatë lëndë | Nuk e di |
| | Në një lëndë deri tri lëndë | Më shumë se shtatë lëndë | |

| | | | | |
|---|--|---------------------------------|--|--|
| 9. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të mia në shkollën e mesme, librat dhe materialet e literaturës kanë qenë në përputhje me kurrikulën. | Në asnjë lëndë | Në katër deri shtatë lëndë | Nuk e di | |
| | Në një lëndë deri tri lëndë | Më shumë se shtatë lëndë | | |
| 10. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të mia në shkollën e mesme, më është dhënë mundësia të jap komente për cilësinë e literaturës që përdoret në klasë. | Në asnjë lëndë | Në katër deri shtatë lëndë | Nuk e di | |
| | Në një lëndë deri tri lëndë | Më shumë se shtatë lëndë | | |
| 11. Në rast se ka ndodhur të ankohem unë, ose ndonjë shok/shoqe, ndonjëherë për cilësinë e dobët të literaturës, komentet tona janë marrë parasyshë. | Në asnjë lëndë | Në katër deri shtatë lëndë | Nuk jam ankuar (Nësë është zgjedhur kjo përgjigjje; kalo tek pyetja 12) | |
| | Në një lëndë deri tri lëndë | Më shumë se shtatë lëndë | | |
| 11.1 Nëse është bërë ankesë; Si është trajtuar çeshtja? | | | | |
| Është marë parasysh dhe është zgjidhur | | | | |
| Është marë parasysh por nuk është zgjidhur | | | | |
| Është anashkaluar si kerkесë | | | | |
| 12. Në përgjithësi, gjatë mësimeve të mia në shkollën e mesme, janë përdorur skripta në vend të librave. | Në asnjë lëndë (Nësë është zgjedhur kjo përgjigjje; kalo tek pyetja 13) | Në katër deri shtatë lëndë | Nuk e di | |
| | Në një lëndë deri tri lëndë | Më shumë se shtatë lëndë | | |
| 12.1 Nëse janë përdorur skripta; Në cilat lëndë janë përdorur? | | | | |
| Cjuhë dhe Letërsi Shqipe | Cjuhë Angleze | Art Figurativ | Sociologji | |
| Matematikë | Edukatë Fizike | Muzikë | Psikologji | |
| Kimi | Biologji | Fizikë | Filosofi / Tjetër | |
| 13. Në shkollën time ka komitet të caktuar përgjegjës për përzgjedhjen dhe monitorimin e literaturës së përdorur. | Po (Nëse PO, kalo tek 13.1.) | Jo (Nëse JO, kalo tek 13.2.) | Nuk e di (Nëse NUK E DI, kalo tek 13.2.) | |

| | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------|
| 13.1 Nëse PO; Kush e përbën atë? | | | |
| Grup i mësimdhënësve | Mësimdhënës | Grup i Nxënësve | Nxënës, Tjetër. |
| 13.2 Nëse JO; A mendoni se duhet të ketë një komitet monitorues për literaturen shkollore? | Po (Nëse PO, kalo tek 13.2.1.) | Jo (Nëse JO, kalo tek 14) | |
| 13.2.1 Nëse PO; Nga kush duhet të përbëhet? | | | |
| Vetëm nga nxënësit | Vetëm nga mësimdhënësit | Nga të dy palët | Tjetër |
| 14. Në përgjithësi, sa jeni të kënaqur me literaturën shkollore? | | | |
| 1) Aspak i/e kënaqur 2) Deri diku i/e pakënaqur | 3) Mesatarisht i/e kënaqur 4) Deri diku i/e kënaqur | 5) Shumë i/e kënaqur | |
| 15. A keni ndonjë koment, propozim, ankesë rreth literaturës shkollore për të shtuar? | | | |
| Koment i hapur | | | |

